

Vendim nr. 220 datë 07.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

| | |
|-------------------|-----------|
| Fiona Papajorgji, | Kryesuese |
| Sandër Beci, | Anëtar |
| Ilir Toska, | Anëtar |

në datën 07.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (H) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **HYSEN MYSHKETA**, përfaqësuar nga avokat Kastriot Selita, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4197 (501), datë 13.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 11, 17, 41, pika 5, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Hysen Myshketa është i biri i shtetasit I.M., i cili është trashëgimtar i vetëm ligjor dhe testamentar i shtetasve H.M. dhe A.M. Mbi bazën e kërkesës së shtetasit I.M., Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Durrës, me vendimin nr. 930, datë 29.06.1995 ka vendosur t'i rikthejë pronësinë trashëgimtarit I.M. mbi një sipërfaqe trualli prej 5000 m² të lirë, brenda truallit të tij, sipas kufijve përkatës, ta kompensojë atë sipas ligjit për parcelat "A1" dhe "B1" me sipërfaqe 5000 m² truall të lirë dhe për diferencën prej 5691,45 m², si dhe t'i njohë të drejtën e parablerjes së objekteve që ndodhen mbi sipërfaqen 1000 m² të kthyer me këtë vendim.

2. Shtetasja M.T. (pala paditëse në procesin gjyqësor) është trashëgimtare ligjore e vetme e shtetasës I.P., e cila, me vendimin nr. 572, datë 23.02.1996 të Gjykatës së Rrethit Durrës është njohur pronare mbi dy sipërfaqe trualli prej 5 dynymë, të ndodhura në lagjen nr. 1 Durrës, sipas kufizimeve përkatëse. Mbi bazën e këtij vendimi, KKKP-ja, Durrës, me vendimin nr. 1498/1, datë 11.07.1996, ka vendosur të njohë shtetasen I.P. ish-pronare të truallit me sipërfaqe 1 dynym, të ndodhur në lagjen nr. 1, Durrës, por të mos ia kthejë atë, pasi i është njohur me vendim të KKKP-së trashëgimtarëve të H.M. (babait të kërkuesit).

3. Për rrjedhojë, shtetasja M.T. i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e pjeshëm të vendimit nr. 1498/1, datë 11.07.1996 të KKKP-së, Durrës, shfuqizimin e vendimit nr. 930, datë 29.06.1995 të KKKP-së, Durrës, njohjen dhe kthimin e sipërfaqes 1000 m², si dhe fshirjen nga regjistri i pasurive të paluajtshme të kësaj sipërfaqeje trualli të regjistruar në emër të H.M. dhe regjistrimin e saj në emër të paditëses. Sipas paditëses, kjo pronë ka qenë e nënës së saj (shtetasës I.P.), e cila e ka fituar pronësinë në vitin 1939 nga shtetasja H.T. kundrejt çmimit 800 franga ari dhe se pasuria e kthyer të paditurit prej 5000 m² nuk ndodhet dhe as nuk pozicionohet aty ku e ka marrë ai.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11422, datë 23.11.2012, ka deklaruar moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1379 (11-2014-4310), datë 06.10.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar, pasi paditësja nuk arriti të vërtetonte se ishte pronare e ligjshme e pronës objekt konflikti. Sipas asaj gjykate, për sa kohë që KKKP-ja, Durrës ishte shprehur më parë me vendimin nr. 930, datë 29.06.1995 ajo nuk duhej të

shprehej me vendim të dytë për të njëjtin send, por duhej ta orientonte subjektin që t'i drejtohej gjykatës me padi që në atë kohë. Në lidhje me pretendimet e paditëses për kthimin në natyrë të sipërfaqes 1000 m², gjykata ka vlerësuar se akti i përpiluar me shkrim dore i vitit 1939 për shitjen e truallit prej 1 dynmësh nga shtetasja H.V. shtetases I.P. (trashëgimlënësja e paditëses), nuk mund të konsiderohet si veprim juridik për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe nuk mund të shërbejë si mënyrë e fitimit të saj, pasi, bazuar në Kodin e Zogut të vitit 1929, veprimi nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji (me akt publik) dhe, për më tepër, nuk është shkruar as nga vetë personi që pretendohet se ka deklaruar. Po sipas asaj gjykate, nuk rezulton as që shtetasja H.T. të ketë qenë pronare e sendit në kohën e deklaratës, e cila nuk është shoqëruar me vërtetim regjistrimi të pronës në emër të saj. Për sa i përket vendimit nr. 572, datë 23.02.1996 të Gjykatës së Rrethit Durrës, pavarësisht se gjykimi është zhvilluar me palë kundërshtare Seksionin e Financës Durrës, ndërkohë që shteti nuk ka qenë pronar i sendit në atë kohë, duke qenë përpara një gjykimi për vërtetim të faktit juridik, gjykata ka vlerësuar se ai nuk konsiderohet mënyrë e fitimit të së drejtës së pronësisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit paditësja M.T.

6. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2015-1126 (499), datë 12.05.2015, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ai është marrë në zbatim korrekt të ligjit dhe është i bazuar në provat shkresore të nënshtruara shqyrtimit gjyqësor. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë paditësja M.T.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4197 (501), datë 13.09.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 499, datë 12.05.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sipas Kolegjit Civil, paditësja disponon titull pronësie mbi pasurinë objekt shqyrtimi (vendimi nr. 1498/1, datë 11.07.1996 i KKKP-së, Durrës), i cili është i vlefshëm për sa i përket njohjes së pronësisë por që nuk ka disponuar në një nga format që parashikon ligji, pra kthim apo kompensim dhe që është marrë mbi bazën e vendimit nr. 572, datë 23.02.1996 të Gjykatës së Rrethit Durrës, i cili pavarësisht se është me objekt vërtetim fakti, është çështje gjyqësore që është zhvilluar me palë të paditur. Sipas atij Kolegji, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin e saj: i) pa kryer hetim të plotë të çështjes; ii) pa verifikuar dhe ballafaquar pretendimet e palëve; iii) duke vepruar në kundërshtim me nenet 6, 14 dhe 16 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Duke qenë se themeli i mosmarrëveshjes mes palëve qëndron se kush është pronari legjitim dhe i vërtetë i pasurisë objekt shqyrtimi, duke pasur të dyja palët ndërgjyqëse si titull pronësie vendime të KKKP-së, sipas

Kolegjit Civil, në rigjykimin në themel duhen vlerësuar këto çështje: i) kush është pronar legjitim i pasurisë duke u hetuar origjina e prejardhur për secilën palë; ii) cilat janë aktet dokumentare ligjore dhe hartografike që përcaktojnë të drejtën për secilën palë; iii) a është pozicionuar drejt prona e trajtuar për secilën palë nga KKKP-ja, Durrës në përputhje me dokumentacionin ligjor dhe atë hartografik. Për rrjedhojë, duke vlerësuar se mungesa e një hetimi të plotë të çështjes e vë Gjykatën e Lartë në pamundësi që të zgjidhë çështjen brenda kufijve të saj të gjykimit, Kolegji Civil, bazuar në nenin 485, shkronja “c”, të KPC-së, ka vendosur kthimin e saj për rigjykim në gjykatën e apelit.

8. Në datën 30.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës.

II

Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

9.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Kolegji Civil ka marrë në shqyrtim parashtrime dhe prova të paraqitura nga paditësja shumë kohë pas paraqitjes së rekursit, pa ia njoftuar ato kërkuetit si palë e paditur. Nga përmbajtja e vendimit të kundërshtuar rezulton se Gjykata e lartë ka administruar, gjatë kohës që çështja ka qenë në pritje të shqyrtimit, disa parashtrime dhe prova shkresore (pika 20 e vendimit), që nuk i janë komunikuar asnjëherë kërkuetit. Nëse Kolegji Civil do ta kishte informuar kërkuetin, ai do kishte pasur mundësi ta vinte në dijeni se prova e re e paraqitur nga paditësja është shqyrtuar më parë nga gjykata e apelit në bazë të kërkesës së saj për rishikim, për të cilën është vendosur mospranimi.

9.2. *Së drejtës për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka dalë jashtë funksionit të saj si gjykatë e ligjit dhe ka vepruar si gjykatë fakti, duke vlerësuar provat dhe faktet në mënyrë të ndryshme nga sa kanë bërë gjykatat më të ulëta. Në paragrafët 27 dhe 31 të vendimit është ndryshuar ekzistenca e fakteve dhe rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin në fakt dhe është arritur në përfundime të ndryshme. Në të gjithë pjesën arsyetuese të vendimit Kolegji Civil ka bërë vetëm

vlerësim të provave, konkretisht të vendimit nr. 1498/1, datë 11.07.1996 të KKKP-së dhe nuk u është referuar dispozitave ligjore të shkelura nga gjykata e apelit.

9.3. *Parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme*, pasi Kolegji Civil nuk u është referuar shkaqeve të ngritura në rekurs duke dalë tej kufijve të përcaktuar në mjetin e ankimit. Në rekurs nuk rezulton të jetë ngritur asnjë çështje ligji, atij material apo procedural ndërkohë që çështjeve të ngritura në të, përfshirë pretendimeve për provueshmërinë e së drejtës së pronësisë për sipërfaqen 1000 m², u është dhënë përgjigje nga gjykatat e faktit bazuar në provat e paraqitura nga paditësja dhe të administruara e vlerësuara prej tyre. Përmes vendimit të tij (paragrafi 27) Kolegji Civil ka hequr përfundimisht mundësinë për rigjykimin e çështjes në përputhje me parimet e procesit të rregullt, pasi me qëndrimin e tij ka krijuar premisë që një akt i paligjshëm, sikurse është vendimi i KKKP-së i dhënë në favor të paditëses, të konsiderohet nga gjykatat e rigjykimit si një titull i vlefshëm pronësie.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të

ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion. Ai përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke përcaktuar edhe drejtimitet e hetimit gjyqësor për gjykatën e rigjyimit. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se vendime të këtij lloji nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste, kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, përjashtimisht nga rregulli i parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendime të tilla me natyrë jo përfundimtare, që jepen gjatë një procesi gjyqësor, nëse plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës kushtetuese të individit. Në të tilla raste kërkuesi duhet të provojë se shkelja e pretenduar në rastin konkret është e tillë që justifikon shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues, pasi ajo dhe pasojat e saj janë të tilla që nuk mund të riparohen më gjatë rigjyimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese dhe referuar rrethanave të rastit në shqyrtim, vëren se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual kanë të bëjnë, në thelb me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit të ligjit në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjes konkrete për sa i përket përcaktimit të së drejtës së tij të pronësisë. Këto pretendime, për nga natyra e tyre, janë të tilla që duhet të shqyrtohen dhe sqarohen gjatë rigjykimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që është duke u zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë duhet të marrin përgjigje nga ato gjykata në ushtrim të juridiksionit të tyre. Në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim në gjykatën e apelit dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj nuk kanë përfunduar ende, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka ende mjete ligjore efektive në dispozicion për të mbrojtur të drejtën e pronësisë të pretenduar të cenuar, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

15. Edhe për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit, për shkak se Kolegji Civil ka marrë në shqyrtim parashtrime dhe prova të paraqitura nga paditësja shumë kohë pas paraqitjes së rekursit, të cilat nuk i janë njoftuar atij, Kolegji vëren se kërkuesi gjatë rigjykimit të çështjes, ka të gjitha mundësitë të kundërshtojë çdo pretendim dhe provë të paraqitur nga pala tjetër, si dhe të paraqesë provat në mbështetje të pretendimeve të tij.

16. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues. Në këto kushte, duke pasur parasysh se kriteret e legjitimitimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues kanë karakter kumulativ, nuk është e nevojshme të vijohet më tej me verifikimin e plotësisë të kriterëve të tjera të pranueshmërisë së kërkesës.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.